REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:164239

Datë: 23.12.2020

Numri i dokumentit: 01367408

Cnr. 821/2020

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË DEÇAN Departamenti i përgjithshëm civile-juridike e shkallës së parë më gjyqtarin Bekim Avdimetaj,në kontestin e paditësve: M. H. dhe A. H. qe te dytë nga fshati ..... Komuna e .....kundër të paditurevë: Xh. H. te cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Taulant Broqi nga Peja ,N. H., Xh. H., E. H. e përfaqëson më autorizim Xh. H., N. H. te gjithë nga fshati ..... Komuna e ....., nga baza juridikë vërtetim pronësie, gjykata pas mbajtjes seancës te shqyrtimit kryesor publike me datën 18.12.2020, të përpiluar me datën 23.12.2020 mur këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të pohimit)

I. APROVOHET në tersi si bazuar kërkesëpadia e paditësve M. H. dhe A. H. qe te dytë nga fshati ..... Komuna e Deçanit.

II. **VERTETOHET** se paditësi M. H. nga fshati ..... Komuna e .....është pronar në bazë të parashkrimit fitues i palujtshmerisë e cila evidentohet si njësi kadastrale me numër .....,më sipërfaqe 1714 m2 ,prone private në vendin e quajtur Rekat-Rekat si dhe i njësisë kadastrale me numër ..... më sipërfaqe 169 m2 prone private në vendin e quajtur Rekat-Rekat ZK fshati ..... K-Deçan më nga ½..

III. **VERTETOHET** se paditësi A. H. nga fshati ..... Komuna e .....,është pronar në bazë të parashkrimit fitues i palujtshmerisë e cila evidentohet si njësi kadastrale me numër .....,më sipërfaqe 1714 m2 ,prone private në vendin e quajtur Rekat-Rekat si dhe i njësis kadastrale me numër ..... ZK fshati ..... K-Deçan më nga ½.

IV. DETYROHET te paditurit N. H.,Xh. H.,E. H.,N. H.dhe Xh. H. qe te gjithë nga fshati ..... K-……, si trashëgimtare te vetëm ligjore te tani te ndjerit A. (Zh.) H., qe paditësve M. H. dhe A. H. qe te dy nga fshati ..... K-..... te ja njohin te drejtën e pronësisë te përshkruar si ne piken **II** dhe **III** te dispozitivit te këtij aktgjykimi dhe te lejojnë qe paditësit te regjistrohen ne Drejtorin për gjeodezi dhe kadastër ne Komunën e .....si pronar ne afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi.

V. Secila pale ne vete i bart shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

2020:164240

M. H. dhe A. H. qe te dytë nga fshati ..... Komuna e .....kane paraqitur padi ne ketë gjykate me dt.13.11.2020 kundër të padituree vë Xh. H. te cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Taulant Broqi nga Peja ,N. H.,Xh. H.,E. H. e përfaqëson më autorizim Xh. H.N. H.te gjithë nga fshati ..... Komuna e ....., nga baza juridikë vërtetim pronësie.

Paditësit ne padi kane deklaruar me paraardhësin gjegjësisht babain e te padituree A. (Zh.) H. kane jetuar ne një bashkësi familjare gjer ne vitin 1986.
Me rastin e ndarjes se bashkësisë familjare një pjese e pronësie me aeroinqizim te vitit 1983 e kryer ne territorin e Komunës se .....ka mbetur e evidentuar ne emër tani te ndjerit A. (Zh.) H. nga fshati ..... K-Deçan, e qe ne fakt behet fjalë për palujtshmerinë e cila e evidentohet ne njësisë kadastrale me numër ..... ne sipërfaqe 1714m2 ne vendin e quajtur Rekat-Rekat e cila është ne posedim te paditësit M. H..

Ngastra me numër te njësie kadastrale ..... me sipërfaqe 1714 m2 ne është ne posedim te paditësit A. H. dhe ngastra me njësi kadastrale ..... me sipërfaqe 169 m2 me kulturë rruge private si prone e përbashkët e paditësve M. H. dhe A. H. si rruge private, e tera e evidentuar ne emër te ndjerit A. (Zh.) H..

Prove aktvdekja për paraardhësit e padituree A. (Zh.) H..

Nga momenti i shkëputjes se bashkësisë familjare i paditësve me paraardhësin e padituree tani te ndjerit A. H., këto ngastra faktikisht ju kane takuar paditësve M. H. dhe A. H. , te nijetit qe atëherë i kane ne pronësi dhe posedim faktit pa u penguar nga askush ngase këto ngastra përkundër asaj qe me aeroinqizim te vitit 1983 e te jetësuar ne vitin 1990 pas ekspozimit te shikimit publik janë mbetur te evidentuar ne emër te ndjeri A. (Zh.) H..

Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Neni 37 par.1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore parashihet, nëse me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur.

Pretendimet e palëve dhe të autorizuarve të ndërgjyqësve

Paditësi gjatë seancës të shqyrtimit përgatitorë kanë deklaruar se mbetem pranë kërkesë padisë me një plotësim te lëshuar sa i përket petitumit vetëm zona kadastrale ,mbetem pranë petitumit te kërkesë padisë duke cekur se paluajtshmeria e ngastrave te theksuara ndodhet ne zonën kadastrale Hulaj pjesa tjetër mbetet e pa ndryshueshme. Përndryshe ekziston certifikata ne bashkëngjitje te lendes, një herët t heqim dore nga parashtrimi i ankesës nuk i kërkoj shpenzimet procedurale.

I autorizuari i padituri Xh. H. ,av.Taulant Broqi nga Peja, gjate seancës përgatitorë ka deklaruar qëndroj pranë përgjigjes ne padi te padituri dhe te autorizuarit e tyre pas shqyrtimit te padisë te paditësve një zërit deklarojnë se e pohojnë kërkesëpadinë e paditësve ne tersi dhe ne plotësimin e paraqitur ne seance nga ana e paditësit.

I autorizuari i padituri dhe të padituri në përgjigjen në padi të dhen më shkrim te tyre të dorëzuar në gjykatë kanë deklaruar se është e vërtete se paditësit M. dhe A. H. kane jetuar ne bashkësinë familjare më paraardhësi ë te padituree A. (Zh.) H. deri ne vitin 1986. Kur edhe

është bre ndarja e bashkësie familjare dhe se palujtshmërinë e evidentuara si ne ngastër kadastrale me numër ..... me sipërfaqe 1714 m2 vendi i quajtur Rekat-Rekat e cila është ne posedim te paditësit M. H.. Palujtshmerinë si ngastër kadastrale me numër ..... ne sipërfaqe 1714 m2, në posedim te paditësit A. H. dhe palujtshmerisë si ngastër kadastrale me numër ..... me sipërfaqe prej 169 m2 me kulturë rruge private si prone e përbashkët te paditësve te lartcekur, që nga ndarja e bashkësisë familjare ka mbetur e evidentuar në emër te babait tone tani te ndjere A. (Zh.) H..
Po ashtu është e vërtet se paditësit ngastrat kadastrale te përshkruara si me larte,i kanë ne pronësi dhe posedim faktik qe nga viti 1986,kur është bere ndarja e bashkësisë familjarë te pa penguar nga askush.

Te padituri nuk kane pretendime për pronësi ne këto paluajtshmeri pasi qe keto ju kane takuar paditësve me rastin e ndarjes se bashkësisë familjare, andaj i propozojmë gjykatës qe kërkesë padinë e paditësve ta aprovoje ne tërësi si te bazuar.

Paditësi dhe i autorizuari i te padituri dhe te padituri ne fjalën e tyre përfundimtare kanë deklaruar se mbesin pranë deklarimeve si me larte duke ri konfirmuar qe heqin dora nga e drejta e ushtrimit te ankesës dhe e drejta te kërkimit te shpenzimeve te procedurës kontestimore

Neni 10. paragraf 1 është një pjesë e caktuar e sipërfaqes tokësore, e cila është e kufizuar ose mund të kufizohet. Paluajtshmëria përfshinë pasuritë natyrore nëntokësore, bimët me rrënjë nëntokësore dhe objektet tjera të lidhura me bazament tokësor.

Neni 28.Fitimi me parashkrim 1. Një person i cili ka në posedim pronësor një send të luajtshme për dhjetë (10) vite pa ndërprerje të posedimit e fiton pronësinë mbi këtë send. 3. Nëse pronësia fitohet përmes parashkrimit fitues, shuhen të drejtat e personave të tretë, të cilat të drejta janë krijuar para fitimit të pronësisë, përveç nëse pronari posedues nuk është me mirëbesim lidhur me këto të drejta gjatë fitimit të posedimit pronësor.

Neni 40.Fitimi me parashkrim 1. Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të. 2. Personi i cili e ka dhjetë (10) vjet në posedim të pandërprerë nj paluajtshmëri të ligjit Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të Republikës së Kosovës.

Pasi që gjykat bëri vlersimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjithave së bashku e në lidhmëri njera me tjetrën e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në perfundim se në këtë çështje juridiko kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Administrimi i provave gjate seancës të shqyrtimit përgatitorë

Gjykata gjate seancës të shqyrtimit kryesor ka bere administrimin e provave:

- Lexohet padia e paditësit e dorëzuar ne gjykatë me dt.13.11.2020,
- Lexohet certifikata e pronës ne emër te A. H. me numër 12-036-2020 e lëshuar me 28.05.2020 na zyra kadastrale K-.....
- Lexohet deklarata për bashkësi familjarë me numër serik F10973281 ne emër te N. H. e lëshuar nga zyra e gjendjes civile ..... me 10.08.2020

- Lexohet certifikata e vdekjes me numër 7 me nr.te ref.1/2000RV/2001 ne emër te A. H. i cili ka vdekur me dt.06.04.2000 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile ne ..... me dt.04.06.2020

- Lexohet përgjigja ne padi e hartuar me dt.11.12.2020 e dhëne nga te padituri e dorëzuar ne gjykate drejt per se drejti ne seance

- Lexohet autorizimi qe ja ke dhëne i padituri drejt për se drejti ne seance te autorizuari qe e përfaqëson si dhe shkresat e lendes.

  Te cilave provave të lartshënuar qe gjenden në shkresat e lendes gjykata ja ka falure besimin.

Baza ligjore

Pasi që gjykat bëri vlersimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjithave atyre së bashku e në lidhmëri njera me tjetrën dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si më lart gjykata erdhi ne përfundim dhe vërtetoj në mënyre të padyshimtë se kërkesëpadia e paditësve në tersi është e bazuar në kuptim të Nenit 10. par 1,Nenit 28.par1,3 nenit 40. par 1. të ligjit Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të Republikës së Kosovës duke vendosur si në dispozitive të këtij aktgjykimit .

Pasi qe paditësit dhe i autorizuari i të paditurit dhe te paditurit gjate seancës përgatitorë në zërit kanë hequr dore nga kërkesa për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata ka vendosur ne baze nenit 463 LPK.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitv te këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA DEÇAN, C.nr.821/2020
i përpiluar më datën 23.12.2020

G J Y Q T A R I
Bekim Avdimetaj

KËSHILLA JURIDIKE :
Pasi qe palët ndërgjyqëse dhe te autorizuarit e tyre kanë hequr dore një zërit nga e drejta e ushtrimit të ankesës gjate seancës të shqyrtimit përgatitorë, ky aktgjykim behet i plotfuqishëm nga dita marrjes se tij.